



**Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)  
PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM  
16 Mars 2012**

## **NJOFTIM PËR MEDIA JAVA E GRUAS NË KOSOVË 2012**

**PRISHTINË** —100 gra përfaqësuese të partive politike, kuvendit të Kosovës, qeverisë, nga akademia, shoqëria civile dhe nga biznesi do të bashkohen për një javë për të diskutuar dhe identifikuar mundësitë që do të ndihmojnë gratë të jenë më efektive dhe më të suksesshme në fushën e tyre të zgjedhur. NDI në vitin 2010 më një aktivitet një javor ndihmoi gratë kandidate për Zgjedhjet 2010 në mënyrë që gratë të kenë shkathtësitë e nevojshme për të kandiduar. Këtë vit, NDI në bashkëpunim me Grupin e Grave Deputete kanë bashkëpunuar për të zgjeruar një aktivitet të ngjashëm për gratë e ardhshme lidere.

*Java e Gruas 2012 do të filloj më 20 Mars dhe përfundoj me 24 Mars në Prishtinë. Dita e parë, sesioni i parë i Gruas në Leadership do të mbahet në Hotelin Swiss Diamond. Dita e 2,3 dhe 4 do të mbahet në Universitetin Amerikan të Kosovës. Dita e pestë do të përmbyllet me një ceremoni në Hotelin Swiss Diamond.*

*Temat e kësaj jave do të jenë: Gratë në Leadership; Gratë në Ekonomi; Gratë në Politikë dhe Shoqëri Civile dhe Gratë në Media.*

*Aktivitetet e secilës ditë do të fillojnë në ora 10 të mëngjesit, ndërsa dita e pestë do ta përfundoj javën duke filluar nga ora 12 pasdite me një ceremoni të certifikimit.*

Pjesëmarrëse të kësaj ngjarje do të jenë: Këshilltare te Asambleve Komunal; Deputetet e Kuvendit të Kosovës; aktivistë të partive politike, gratë që planifikojnë të kandidojnë, profesorë, studentë, gra në biznes dhe nga shoqëria civile dhe përfaqësues nga media. Pjesëmarrësit e kësaj ngjarje do të përfaqësojnë gjithë rajonet e Kosovës, me përbërje ndëretnike dhe nga gjenerata të ndryshme.

Folësit e javës së gruas do të jenë ekspertë politikë ndërkombëtar dhe të komunikimit dhe gra udhëheqëse nga rajoni dhe gratë lidere të Kosovës

Për më tej folëse të kësaj jave do të jenë edhe:

**Atifete Jahjaga** Presidente e vendit

**Laura Nichols**, Drejtore e NDI në Kosovë

**Mimoza Kusari**, Zv.Kryeministre dhe Ministre për Tregti dhe Industri

**Cathy Allen**, Presidente e Connections Group

**Edita Tahiri**, Zv Kryeministre

**Teuta Arifi**, Zv.Kryeministre e Maqedonisë për Integritet Evropian

**Nada Orobnjak**, Deputete e Kuvendit të Malit të Zi dhe Kryetare e Komisionit për Barazi Gjinore

**Rudina Xhunga**, gazetare në Top Chanel,

**Afërdita Saraçini**, Drejtore e Përgjithshme e RTV 21

**Linda Gusia**, Sociologe

**Bonnie Bawnlee**, Këshilltare për Komunikim

**Anamari Repic**, Zv.Drejtore e Pwrgjithshme e RTK-sw

**Pamela Hart**, Drejtoreshw Ekzekutive e Relase Your Voice

Për më shumë informata për Javën e Gruas ju lutem kontaktoni Arta Qorri në [agorri@ndikv.org](mailto:agorri@ndikv.org)  
apo ne nr. e telefonit +377 44 170 703.

###